AVOKATI I POPULLIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr.K/I 181-5 Prot.
Nr. Doc.202501666/5

Tiranë 22/5/2026

Lënda : *Rekomandim për aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuar në Objektet e Trashëgimisë Kulturore, në Gjirokastër.*

DREJTORISË RAJONALE TË TRASHËGIMISË KULTURORE
GJIROKASTËR

Për dijeni: MINISTRISË SË TURIZIMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
TIRANË

INSTITUTIT KOMBËTAR TË TRASHËGIMISË KULTURORE
TIRANË

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion i pavarur, në ushtrimin e funksioneve të tij sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, ka një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike.

Adresimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe interesave të tjera të ligjshme si edhe ofrimi i mundësive të barabarta për të gjitha grupet vulnerabël, përfshirë personat me aftësi të kufizuar, është pjesë e prioriteteve strategjike të Avokatit të Popullit.

Sipas Nenit 16 të Ligjit nr. 93/2014 *"Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara"*, Avokati i Popullit është përcaktuar si një institucion monitorues për zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën e OKB-së *"Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara"*.

Në këtë kontekst, në përputhje me paragrafin e parë të Nenit 13, të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, bazuar në punën e tij të përditshme, ankimet e bëra pranë insitucionit, rastet e ndërmarra me iniciativë, nisur edhe nga problematikat e paraqitura gjatë tryezave të rrumbullakta me organizatat e shoqërisë civile, që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara, duke iu referuar konkretisht gjetjeve dhe rekomandimeve në kuadër të zbatimit të Projektit "Turizëm i aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara në Tiranë", zbatuar nga Fondacioni "Së Bashku"[1], Avokati i Popullit vlerësoi si të nevojshëm marrjen me iniciativë të çështjes dhe kryerjen një vlerësimi për aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar në objektet e trashëgimisë kulturore, në të gjithë vendin.

Personat me aftësi të kufizuara vijojnë të përballen me barriera të natyrës fizike, infrastrukturore dhe funksionale, të cilat cenojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ushtrimin efektiv të së drejtës së tyre për të aksesuar dhe vizituar objektet e trashëgimisë kulturore, përfshirë muzetë dhe vendet me vlera historike e kulturore. Këto pengesa konstatohet se shfaqen si në hapësirat e jashtme të këtyre objekteve, ashtu edhe në ambientet e brendshme, ku në mënyrë të përsëritur evidentohet mungesa e infrastrukturës ndërtimore të përshtatur, e pajisjeve ndihmëse dhe e zgjidhjeve teknike që mundësojnë akses të barabartë, të sigurt dhe dinjitoz për personat me aftësi të kufizuara.

Në këtë kontekst, garantimi i aksesueshmërisë së personave me aftësi të kufizuara në të gjitha objektet, produktet dhe shërbimet turistike përbën një të drejtë themelore dhe një detyrim pozitiv të institucioneve përgjegjëse, i lidhur ngushtë me realizimin e jetesës së pavarur, pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në jetën shoqërore, kulturore dhe publike, si dhe me respektimin e parimeve të barazisë, mosdiskriminimit dhe përfshirjes sociale.

Në vijim të sa më sipër, për qëllime të hetimit administrativ, të orientuar drejt garantimit efektiv të së drejtës së personave me aftësi të kufizuara për një mjedis gjithëpërfshirës, si dhe për përfitimin e shërbimeve publike dhe kulturore në kushte barazie me pjesën tjetër të popullsisë, Institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastër me një kërkesë zyrtare për informacion[2], lidhur me sa më poshtë vijon:

- Numrin e përgjithshëm të objekteve të trashëgimisë kulturore, përfshirë muzetë, që ndodhen nën juridiksionin dhe administrimin e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastër;

- Gjendjen e aksesueshmërisë së këtyre objekteve për personat me aftësi të kufizuara në lëvizje, në dëgjim dhe në shikim, duke specifikuar nëse dhe në çfarë mase ato janë të

[1] Link : REKOMANDIME PËR TURIZËM TË AKSESUESHËM PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA – Fondacioni Se Bashku

[2] Shkresa nr. K1/I181-2 prot., datë 27.09.2024 "Kërkesë për informacion". Kjo kërkesë bazohet në pikën 4, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet shprehimisht se; "*Organet dhe funksionarët publike janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjithë dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij*", si dhe në gërmën "b", të nenit 19, të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se: "*Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qëndrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin*".

përshtatura, si në aspektin e infrastrukturës ndërtimore të jashtme dhe të brendshme të godinave.

Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Gjirokastër informon[3] *se: ka nën administrimin e saj objektet e mëposhtme të trashëgimisë kulturore, të hapura dhe të aksesueshme për vizitorë vendas dhe të huaj:*

1. *Kalaja e Gjirokastrës;*
2. *Rrënojat e Teatrit të Adrianopolit;*
3. *Kalaja e Libohovës;*
4. *Parku Arkeologjik Antigone.*

Sipas informacionit të dhënë: ***Kalaja e Gjirokastrës*** *dhe Parku* ***Arkeologjik Antigone*** *janë objekte ku ka personel të dedikuar për kontrollin e vizitorëve dhe për mirëmbajtjen e përhershme, si dhe konsiderohen të aksesueshme edhe për personat me aftësi të kufizuara në lëvizje. Megjithatë, theksohet se për shkak të karakteristikave të veçanta fizike dhe topografike të këtyre objekteve, përfshirë pjerrësitë, ngjitjet dhe rrugët e paasfaltuara, ekzistojnë vështirësi objektive që kufizojnë aksesin e plotë dhe të pavarur për këtë kategori personash.*

Në ***Kalanë e Gjirokastrës*** *janë vendosur gjithashtu tabela informuese të përshtatura në alfabetin "Braille", në funksion të përmirësimit të aksesit për personat me aftësi të kufizuara në shikim.*

Sa i përket ***Kalasë së Libohovës*** *dhe* ***Rrënojave të Teatrit të Adrianopolit,*** *informohet se këto objekte janë të hapura dhe të aksesueshme për të gjithë vizitorët, përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara, pa barriera ndaluese formale. Megjithatë, evidentohen vështirësi objektive të lidhura me mungesën e rrugëve të shtruara dhe të infrastrukturës së përshtatur, çka e bën të pamundur lëvizjen e lirë dhe të sigurt me karroca për personat me aftësi të kufizuara në lëvizje. Këto objekte ndodhen në terrene të hapura natyrore, të cilat mund të shfrytëzohen nga vizitorët, por pa garantuar standarde të plota aksesueshmërie universale.*

Nga analiza e përgjigjeve të përcjella nga Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Gjirokastër rezulton se, në nivel deklarativ dhe praktik, janë ndërmarrë disa masa pozitive në drejtim të garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara në objektet e trashëgimisë kulturore nën administrimin e saj. Veçanërisht, vlerësohet prania e personelit të dedikuar për mirëmbajtje dhe menaxhim të vizitorëve në disa prej këtyre objekteve, si dhe ndërmarrja e masave specifike për përmirësimin e aksesit në informacion, si vendosja e tabelave në alfabetin "Braille" në Kalanë e Gjirokastrës, në funksion të personave me aftësi të kufizuara në shikim.

Megjithatë, nga shqyrtimi i detajuar i informacionit të dhënë, konstatohet se aksesueshmëria e personave me aftësi të kufizuara në këto objekte mbetet kryesisht e kufizuar, duke u ndikuar ndjeshëm nga mungesa e infrastrukturës ndërtimore të përshtatur dhe e zgjidhjeve teknike, që do të mundësonin një akses të plotë, të sigurt dhe të pavarur, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara në lëvizje. Referimi i përsëritur ndaj "vështirësive objektive" të lidhura me karakteristikat topografike, terrenin e hapur dhe

[3] Shkresa kthim përgjigje e DRTK Gjirokastër nr.604/1 prot., datë 10.10.2024

mungesën e rrugëve të shtruara tregon se, ndonëse objektet janë formalisht të hapura për të gjithë vizitorët, standardet e aksesueshmërisë universale nuk rezultojnë të përmbushura.

Për rrjedhojë, ndonëse përgjigjet e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastër evidencojnë një qasje pozitive dhe një vullnet për përfshirje, ato njëkohësisht nxjerrin në pah nevojën për ndërhyrje të mëtejshme, të planifikuara dhe progresive, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kuadrin ligjor kombëtar, me qëllim garantimin e aksesueshmërisë së plotë dhe të barabartë për personat me aftësi të kufizuara në objektet e trashëgimisë kulturore.

Ndërkohë që në Kalanë e Gjirokastrës janë vendosur tabela informuese të përshtatura në alfabetin "Braille", në funksion të aksesit në informacion për personat me aftësi të kufizuara në shikim, vlerësohet se ekziston ende hapësirë për përmirësime të mëtejshme. Në këtë drejtim, paraqitet e nevojshme zgjerimi i masave mbështetëse përmes pajisjes së objektit me sisteme audioguide dhe mjete të tjera të komunikimit të aksesueshëm, të cilat do të mundësonin përfitimin e përmbajtjes kulturore edhe për vizitorët me aftësi të kufizuara në dëgjim dhe në shikim, në përputhje me parimin e aksesit të barabartë në informacion.

Po ashtu, nga informacioni i administruar rezulton se aktualisht nuk ofrohen shërbime të posaçme të transportit ndihmës, si mjete apo karroca të përshtatura për lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara në terrene të pjerrëta, malore ose në zona me hapësira të ngushta. Mungesa e këtyre mjeteve kufizon ndjeshëm mundësinë e një lëvizjeje të pavarur dhe të sigurt brenda objekteve të trashëgimisë kulturore dhe përbën një pengesë faktike për ushtrimin e plotë të së drejtës për aksesueshmëri.

Sa i përket **Kalasë së Libohovës** dhe **Teatrit të Adrianopolit**, konstatohet se këto objekte, duke mos disponuar aktualisht rrugë të shtruara dhe të përshtatshme për qarkullim, paraqesin kufizime të konsiderueshme në aspektin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Në këtë kuadër, vlerësohet si thelbësore ndërmarrja e ndërhyrjeve për krijimin e rrugëve të shtruara dhe të lëmuara, të cilat, duke respektuar karakterin e objekteve të trashëgimisë kulturore, të mundësojnë lëvizjen e sigurt, të pavarur dhe dinjitoze, si dhe të garantojnë një përvojë vizite më të lehtë dhe gjithëpërfshirëse.

Ndërkohë, në rastet kur këto objekte konsiderohen të aksesueshme, sipas informacionit të përcjellë nga institucionet përgjegjëse, rezulton e domosdoshme që kjo aksesueshmëri të mos mbetet vetëm formale, por të shoqërohet edhe me sigurimin e infrastrukturës ndihmëse përkatëse. Në këtë drejtim, paraqitet si e nevojshme krijimi i ambienteve të përshtatshme, përfshirë tualete të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, si dhe hapësira funksionale që mundësojnë manovrimin e lirë dhe të sigurt të karrigeve me rrota, në përputhje me standardet e aksesueshmërisë universale.

Implementimi i teknologjive ndihmëse përbën një standard ndërkombëtar të konsoliduar, i njohur dhe i rekomanduar për t'u zbatuar në vendet historike, muzetë dhe objektet e trashëgimisë kulturore, me qëllim garantimin e aksesit të barabartë dhe gjithëpërfshirës në informacion dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara.

Në këtë kuadër, vlerësohet se do të ishte e dobishme, që edhe në objektet e trashëgimisë kulturore në **Rajonin e Gjirokastrës,** të ndërmerren masa konkrete për vënien në

përdorim të aplikacioneve dixhitale në pajisje inteligjente (smartphone), të cilat të ofrojnë informacione të personalizuara për vizitorët me aftësi të kufizuara, si dhe të shërbejnë si mjete ndihmëse për orientimin në terren, në përputhje me parimet e aksesueshmërisë universale dhe të akomodimit të arsyeshëm.

Trajnimi i personelit dhe ofrimi i asistencës për vizitorët, përbën një element thelbësor për përmbushjen e standardeve minimale të aksesueshmërisë dhe të cilësisë së shërbimit për personat me aftësi të kufizuara, në vendet dhe objektet e trashëgimisë kulturore. Ky komponent është i pandashëm nga masat infrastrukturore dhe teknologjike, duke qenë se garanton funksionimin efektiv dhe përdorimin real të tyre.

Në këtë kuadër, rezulton e domosdoshme, që stafi i angazhuar në administrimin dhe shërbimin ndaj vizitorëve në këto objekte të trajnohet në mënyrë të posaçme për ofrimin e shërbimeve të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara. Trajnimi duhet të synojë pajisjen e personelit me njohuri dhe aftësi praktike për të ofruar orientim të duhur, asistencë gjatë lëvizjes dhe mbështetje në përdorimin e infrastrukturës dhe pajisjeve të aksesueshme, me qëllim garantimin e një përvoje visitë sa më të sigurt, dinjitoze dhe gjithëpërfshirëse.

Mungesa e një personeli të trajnuar në këtë drejtim rrezikon ta kthejë aksesueshmërinë në një koncept formal, duke cënuar në praktikë ushtrimin efektiv të së drejtës së personave me aftësi të kufizuara për pjesëmarrje të barabartë në jetën kulturore.

Detyrimi për t'u garantuar personave me aftësi të kufizuara ushtrim të plotë dhe efektiv të të gjitha të drejtave të tyre në marrjen e shërbimeve publike, si dhe për të siguruar jetesën e tyre të pavarur, rrjedh, ndër të tjera, drejtpërdrejt nga **Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara**[4], të cilën Republika e Shqipërisë e ka ratifikuar dhe është e detyruar ta zbatojë.

Heqja e barrierave fizike, infrastrukturore, komunikative dhe institucionale përbën një nga parimet themelore të kësaj Konvente, duke qenë se vetëm përmes eliminimit të këtyre pengesave personat me aftësi të kufizuara mund të gëzojnë dhe të ushtrojnë në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat e tjera të sanksionuara në të. Ky parim lidhet drejtpërdrejt me garantimin e jetesës së pavarur dhe me përfshirjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në jetën shoqërore, kulturore dhe publike.

Në këtë kontekst, Konventa, në nenin 9 të saj, parashikon detyrimin pozitiv të shteteve palë për të ndërmarrë masa të përshtatshme me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, duke garantuar që objektet, mjediset dhe shërbimet e destinuara për publikun të jenë të aksesueshme edhe për personat me aftësi të kufizuara. Për këtë qëllim, shteteve palë u kërkohet të adoptojnë masa konkrete dhe efektive, të cilat synojnë eliminimin e barrierave ekzistuese dhe parandalimin e krijimit të pengesave të reja, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara të mund të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës.

---

[4] Ratifikuar nga shteti shqiptar me Ligjin Nr. 108/15.11.2012 "Për ratifikimin e Konventës së OKB-së "Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara".

Për më tepër, **neni 30, pika 1, germa (c)** e **Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara** vendos objektet e trashëgimisë kulturore në qendër të detyrimeve pozitive të shtetit për garantimin e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara. Sipas kësaj dispozite, shtetet palë njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë, në mënyrë të barabartë me të tjerët, në jetën kulturore të vendit dhe janë të detyruara të ndërmarrin të gjitha masat e duhura për të garantuar që këta persona të gëzojnë akses efektiv në institucionet dhe shërbimet kulturore, si teatrot, muzetë, kinematë, bibliotekat, si dhe shërbimet turistike, duke përfshirë, për sa është e mundur, edhe aksesin në monumentet dhe qendrat me rëndësi për kulturën kombëtare.

Në vijim të këtij kuadri normativ, **Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara**, si organ mbikëqyrës për zbatimin e Konventës, në rekomandimet e miratuara më datë 25.09.2019 për Shtetin Shqiptar, ka theksuar nevojën për ndërmarrjen e masave konkrete në funksion të garantimit të së drejtës së personave me aftësi të kufizuara për të jetuar në mënyrë të pavarur dhe për t'u përfshirë në komunitet.

Një nga shqetësimet kryesore të evidentuara nga Komiteti lidhet me mungesën e aksesueshmërisë në mjedise dhe shërbime publike, duke vënë theks të veçantë në domosdoshmërinë e respektimit të standardeve për heqjen e barrierave mjedisore dhe infrastrukturore në ofrimin e shërbimeve, si një kusht thelbësor për ushtrimin real dhe jo thjesht formal të të drejtave të garantuara nga Konventa.

Axhenda e miratuar në samitin e Kombeve të Bashkuara, "*Për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2015-2030*", objektivin nr.9[5] përpos promovimit të industrializimit gjithëpërfshirës e nxitjes së inovacionit, e lidh edhe me ndërtimin e infrastrukturës elastike (fleksibël) dhe të qëndrueshme.

Në nën objektivin 9.1 është përcaktuar se:
-Zhvillimi i një infrastrukture cilësore, të qëndrueshme dhe elastike, duke përfshirë infrastukturën rajonale dhe ndërkufitare, për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe mirëqënien njerëzore, me një fokus në qasje të përballueshme dhe të barabartë për të gjithë."

Organizata e Kombeve të Bashkuara, në kuadër të programit "Turizëm të Aksesueshëm për të gjithë" thekson se: "*Aksesueshmëria është një element qendror i çdo politike zhvillimi të përgjegjshme dhe të qëndrueshme. Është një domosdoshmëri për përmbushjen e të drejtave të njeriut, ashtu edhe një mundësi e jashtëzakonshme biznesi. Në këtë kontekst, turizmi i aksesueshëm nuk u sjell dobi vetëm personave me aftësi të kufizuara, por i sjell dobi të gjithë shoqërisë.* "[6]

Organizata Botërore e Kombeve të Bashkuara për Turizmin, vlerëson se: "*Turizimi luan një rol kyç në zhvillimin ekonomik dhe ofron një sërë përfitimesh, megjithatë duhet të jetë i qendrueshëm dhe gjithëpërfshirës për të gjithë. Duke përfshirë që në fillim parimet e aksesueshmërisë, kostot e investimit mund të mbahen në minimum. Duke u angazhuar për barazi, kompanitë e turizmit bëhen më të qëndrueshme, tërheqin vizitorë të rinj dhe mund të punësojnë njerëz me diversitet funksional.* "

---

[5] Objektivi 9. Ndërtimi i infrastrukturës elastike (fleksibël), promovimi i industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxitja e inovacionit.

[6] https://social.desa.un.org/issues/accessible-tourism-for-all

Në këtë kontekst, kjo Organizatë ka dhënë rekomandime[7] dhe ka zhvilluar edhe manuale, lidhur me standardet që duhet të plotësohen për aksesueshmërinë të cilat përfshijnë:

- aksesin fizik në mjediset muzeale;
- udhërrëfyes audio dhe gjuhë të shenjave;
- shërbime të transportit të brendshëm;
- sinjalistikë universale;
- trajnimin e stafit;

Në përputhje me instrumentat ndërkombëtarë, sa i përket të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në lidhje me aksesueshmërinë, edhe legjislacioni i brendshëm ka parashikime ligjore konkrete.

Në përputhje me standardet e përcaktuara në Konventën e OKB-së "Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara", është miratuar nga Shqipëria ligji i brendshëm, nr. 93/2014 *"Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara"*.

Ky ligj garanton nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

Një nga qëllimet e këtij ligji është përcaktimi i përgjegjësisë së të gjitha strukturave publike dhe jopublike, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në mënjanimin total, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri.

Aksesueshmëria kërkon që politikat, legjislacioni dhe praktikat që ndiqen, të mos përjashtojnë personat me aftësi të kufizuara.

Në zbatim të këtij ligji, masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave për mënjanimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore për ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara, janë parashikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1074, datë 23.12.2015 "*Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara*", i ndryshuar.

Ky vendim e shtrin zbatimin mbi të gjitha ndërtimet e strukturat ndërtimore të reja dhe ekzistuese, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, kryesisht objektet e shëndetit publik, banesat dhe objektet rezidenciale, shkollat dhe institucionet shkencore, **objektet kulturore,** objektet e kultit, qendrat tregtare, institucionet administrative e të shërbimit publik, ndërmarrjet e qendrat e punës, në mjediset e të cilave ofrohen shërbime publike, parqet, sheshet e rrugët.[8]

Sipas këtij vendimi, konsiderohen si pengesa infrastrukturore sa më poshtë:

---

[7] https://webunwto.s3.eu-west-1.amazonaws.com/s3fs-public/2023-09/Cultura-ING_ACC.pdf?VersionId=JUTDNht8hNBZdgAeBayWzv.ZOqlD.Eta

[8] Kreu I, pika 4/b, i VKM nr.1074, datë 23.12.2015, *"Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara"*.

- Pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtdo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar, të përhershme ose të përkohshme.
- Pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve e të pjesëve përbërëse.

Sjellim në vëmendje se, dispozitat e parashikuara në këtë vendim duhen zbatuar me rigorozitet, për të garantuar një mjedis pa pengesa për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara, duke u mundësuar këtyre të fundit aksesin në shërbimet publike, përfshirë këtu edhe në objektet kulturore.

Për përshtatshmërinë e infrastrukturës ndërtimore, të hapësirave për përdorimin nga personat me aftësi të kufizuara, me qëllim lehtësimin e lëvizjes së tyre, element i detyrueshëm është planifikimi në përputhje me standardet e përshtatshmërisë për këta persona. Ligji nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, në nenin 45/1, ka përcaktuar:

- Të gjitha ndërtimet për banesa, hapësira dhe shërbime për publikun, përfshirë parqet, sheshet dhe rrugët, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të plotësojnë kërkesat dhe standardet e përshtatshmërisë për personat me aftësi të kufizuara;
- Autoritetet përgjegjëse të institucioneve që ofrojnë shërbime për publikun janë të detyruar të sigurojnë një nivel bazë të përshtatshmërisë ndërtimore në mjediset ekzistuese në administrim të tyre.

Në Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar (PKVPAK) 2021-2025, aksesueshmëria evidentohet si një pengesë kryesore për të gjitha fushat, duke ritheksuar edhe një herë rëndësinë themelore që ka përmirësimi i saj për të realizuar integrimin e plotë të personave me aftësi të kufizuar në Shqipëri.

Duke u bazuar në detyrimet ndërkombëtare, legjislacionin shqiptar në fuqi, si dhe analizën e situatës aktuale në objektet e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastër, theksojmë se:

Aksesueshmëria është një detyrim ligjor, një kërkesë e standardeve ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është palë dhe një kusht thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit kulturor.

Në këto kushte, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*", si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999, "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*":

REKOMANDON:

1. Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Gjirokastër, brenda 90 ditëve nga marrja dijeni e këtij rekomandimi, të hartojë dhe miratojë, sipas një procesi konsultimi gjithëpërfshirës me organizatat përfaqësuese të Personave me Aftësi të

Kufizuara, një Plan Masash për aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara në objektet e trashëgimisë kulturore në administrim të saj, duke i vendosur në dispozicion Avokatit të Popullit kopje të dokumentit, që përmban:

a) inventarin e barrierave aktuale fizike, të komunikimit dhe të shërbimeve për secilin objekt;

b) masat e parashikuara teknike dhe organizative për eliminimin e këtyre barrierave;

c) prioritetet e ndërhyrjeve sipas fluksit të vizitorëve dhe riskut të përjashtimit;

ç) kalendarin e procesit të konsultimit publik.

2. Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Gjirokastër, brenda 180 ditëve nga marrja dijeni e këtij rekomandimi, të miratojë dhe të dërgojë pranë Avokatit të Popullit kalendarin e trajnimeve periodike të stafit të objekteve të trashëgimisë kulturore, me fokus ofrimin e shërbimeve të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara, që përfshin:

a) orientimin dhe komunikimin e asistuar;

b) garantimin e sigurisë gjatë vizitës;

c) ndihmën praktike në përdorimin e infrastrukturës së përshtatur.

Afati për përgjigje

Në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999 *"Për Avokatin e Popullit"*, të ndryshuar, ju lutemi të na ktheni përgjigje me shkrim brenda 30 ditëve nga marrja e këtij rekomandimi, duke njoftuar masat e marra për zbatimin e tij.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERE

Vilma SHUPTHA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AVOKATI I POPULLIT

Konceptoi: B. Dervishaj
Datë 28.01.2026
Rishikoi 21.05.2026